



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

K.Dh.Sh.II.nr.1188/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS– Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovë, Sh.A. me seli ne Prishtinë, kundër debitorëve: 1.Melodia Projekt Sh.p.k me numër të biznesit 811023936 me adresë në Davidoc Shtime, 2.I.A. me adresë në Davidoc Shtime, 3.B.A. me adresë në Davidoc Shtime, 4. Sh.Z. me adresë në rr.”Shefket Muhadini” Shtime dhe 5.V.A. me adresë në rr.”Martirët e Lirisë” Kaçanik, objekt përmbarimi pagesën e kredisë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2025/2022 të datës 31.07.2023, me datën 17.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit B.A. me adresë në Davidoc Shtime ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2025/2022 të datës 31.07.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2025/2022 të datës 31.07.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit B.A., i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.111/2022 të datës 17.03.2022, i lejuar nga Përmbaruesit Privat Saranda Rexhepi, në pikën II të dispozitivit e ka lënë në fuqi urdhërin përmbarimit P.nr.111 /2022 të datës 17.03.2022, i lejuar nga Përmbaruesit Privat Saranda Rexhepi.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë kanë parashtruar debitori për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovet ankesa e debitorit në tersi si e bazuar dhe të anulohet aktvendimi i ankimuar si dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkalës së parë.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në ankesë, duke propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar ankesa e debitorit dhe aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2025/2022 të datës 31.07.2023, të mbetet në fuqi.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Zyra Përbarimore e përbaruesit privat Privat Saranda Rexhepi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përbarimor me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të Marrëveshjes mbi Pengun e datës 16.10.2019 për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja mbi Kredinë Nr. 200722722 dhe Marrëveshja mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Biznes kredit kartelës e datës 22.11.2018, marrëveshje kjo e regjistruar në regjistrin e pengut sipas konfirmimit mbi rregjistrimin e pengut me R-20191021-388 dt.21.10.2019 te datës 08.11.2019 dhe Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20220310-6189 dt. 21.10.2019 të cilat dokumente paraqesin dokumente përbaruese në bazë të nenit 5 par 2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore.

Kundër propozimit për përbarimin, prapsim ka paraqitur debitori në afat të rregullt ligjor, me të cilin ka theksuar se debitori me anë të këtij prapësimi në tërësi e kundërshton urdhrin e përbaruesit privat për arsye se urdhëri është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së pasi që propozimi për përbarim nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numërin regjistrimit të biznesit dhe si tillë nuk plotëson kushtet ligjore për përbarim. Ka shtuar se debitori ka kërkuar shtyrjen e kredisë gjatë kohës së pandemisë dhe

ka kominikuar përmesë telefonit me analistin e bankës i cili i ka premtuar se do ti shtyjë këstet dhe do ta ri programoj marrëveshjen për kredinë mirëpo i njëjti nuk e ka marrë seriozisht kërkesën e debitorit, si dhe ka propozuar që të pranohet prapësimi si e bazuar.

Kreditorët brenda afat ligjore kanë paraqitur përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar pretendimet e debitorit dhe duke propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorëve si i pa bazuar.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit dhe përgjigje në prapësim të kreditorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar, në pikën I të dispozitivit, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit B.A., i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.111/2022 të datës 11.03.2022, i lejuar nga Përmbaruesit Privat Saranda Rexhepi, në pikën II të dispozitivit e ka lënë në fuqi urdhërin përmbarimit P.nr.111/2022 të datës 11.03.2022, i lejuar nga Përmbaruesit Privat Saranda Rexhepi. Me arsyetim se Marrëveshja mbi Pengun e datës 16.10.2019 për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja mbi Kreditin me nr.200722722 dhe Marrëveshja mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Biznes kredit kartelës e datës 22.01.2018 gjeti se e njëjta është regjistruar në regjistrin e pengut sipas konfirmimit mbi regjistrimin e pengut me R-20191021-388 dt.21.10.2019 të datës 08.11.2019, dhe konfirmimit mbi regjistrimin e pengut me R-20220310-6189 dt.21.10.2019, dhe është paraqitur në origjinal dhe si e tillë përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 22 par 1.7a dhe neni 27 të LPP-së, për të qenë të përmbarushëm dhe njëkohësisht për përmbarim.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbarimore. Konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore të procedurës përmbarimore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të neni 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se, Gjykata e Dhomës së shkallës së parë drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ngase dokumentet përmbarimore si që janë Marrëveshja mbi Pengun e datës 16.10.2019 për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja mbi

Kredinë Nr. 200722722 dhe Marrëveshja mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Biznes kredit kartelës e datës 22.11.2018, marrëveshje kjo e regjistruar në regjistrin e pengut sipas konfirmimit mbi rregjistrimin e pengut me R-20191021-388 dt.21.10.2019 te datës 08.11.2019 dhe Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20220310-6189 dt. 21.10.2019, mbi në bazë të të cilave përmbaruesi privat ka zbatuar përmbarimin, janë dokumente përmbaruese të cilat përbejnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 21 ku përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, dhe sipas 27 i LPP-së, përcaktohet se: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, për të qenë të përmbarueshëm dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përmbarim. Po ashtu Marrëveshja mbi pengun e datës 16.10.2019 për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja mbi kredinë me nr.200722722 dhe Marrëveshja mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Biznes kredit kartelës e datës 22.01.2018 rezultojnë se të njëjtat janë të regjistruar në regjistrin e pengut sipas konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20191021-388 dt.21.10.2019 të datës 21.10.2019 të lëshuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e të cilat janë në origjinal, ashtu sipas nenit 36 i LPP-së me të cilën është paraparë se *“ Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarushmërisë për përmbarushmëri, andaj si të tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit sepse janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 22 par 1.7a dhe neni 27 të LPP-së për të qenë të përmbarushëm dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përmbarim.*

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të ankimuar, mori parasysh pretendimet ankimore të debitorit por që të njëjtat i refuzoi si të pa bazuar pasi ishin pa ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarimore.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1188/23, me datë 17.04.2024

Gjyqtarja
Franciska Zhitija Ymeri